



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr./Bil. / No.	869	Nr. i faq/ Bc. str./ No. pg. 10
Data / Datum / Date: 03.04.2024		

KODI PËR ETIKË DHE INTEGRITET I INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE

Pejë, 2024

KODI PËR ETIKË DHE INTEGRITET I INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE

Neni 1

Objekti

Kodi për Etikë dhe Integritet i Institutit për Shkencë dhe Arte (ISHA) të UHZ-së i përmban parimet dhe normat themelore të sjelljes së personelit të ISHA-së, në përputhje me Statutin e UHZ-së, Statutin e ISHA-së, dhe Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor.

Neni 2

Qëllimi

1. Qëllimi i Kodit për Etikë dhe Integritet të ISHA-së është të krijojë një kornizë vetërregulluese për kryerjen e kërkimeve shkencore dhe artistike në përputhje me parimet dhe përgjegjësitë për etikën dhe integritetin e kërkimeve, të cilat kryhen nga personeli i ISHA-së (bashkëpunëtorët shkencorë, bashkëpunëtorët e lartë shkencor, këshilltarët shkencorë, hulumtuesit shkencorë dhe hulumtuesit e pavarur shkencorë).
2. Kodi për Etikë dhe Integritet i ISHA-së synon ta ruajë, ta garantojë dhe ta mbrojë transparencën dhe integritetin akademik, profesional, institucional dhe moral të veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore dhe artistike, si dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare bashkëkohore të veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe artistike

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kodi për Etikë dhe Integritet i Institutit për Shkencë dhe Arte zbatohet për:
 - a. Personelin e ISHA-së;
 - b. Çdo person të angazhuar në ISHA, i përfshirë në kërkimet shkencore dhe artistike brenda institutit, ose në emër të tij.

Neni 4

Termet përkufizues

Termet e përdorur në Kodin etik të ISHA-së kanë kuptimet si më poshtë:

1. **“Bashkautorësia”** është kryerje e një kërkimi / hulumtimi nga më shumë se një anëtar.
2. **“Falsifikimi”** është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit; ndryshimi, heqja ose shmangia e të dhënave ose e rezultateve në

- mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i rezultateve, përkatësisht botimi i tyre si kërkim me vlera shkencore, pa qenë i tillë.
3. **“Komisioni i Etikës”** është instanca më e lartë e shqyrtimit të ankimeve dhe vendosjes së sanksioneve për shkeljet e integritetit në bazë të këtij kodi.
 4. **“Komunitetet akademike e shkencore”** janë institucionet dhe mjedisi ku zhvillohet veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike.
 5. **“Liria akademike dhe liria e kërkimit shkencor”** është e drejta për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme kërkimore në mënyrë të pavarur dhe pa ndikime që lidhen me kërkimin.
 6. **“Parimet e kërkimit shkencor”** janë parimet që i orientojnë kërkuesit në veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore dhe artistike.
 7. **“Përgjegjësia akademike dhe kërkimore”** është detyrimi për t'i zbatuar parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikes në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike.
 8. **“Plagjiatura”** është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve si të vetat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe punën e tyre intelektuale.
 9. **“Procedurat e kërkimit shkencor”** i përfshijnë pyetjet kërkimore, hipotezat, analizën, formulimin e rekomandimeve, përdorimin e burimeve dhe raportimin e rezultateve të kërkimit shkencor.
 10. **“Sanksionet”** janë masat disiplinore dhe penalizuese që merren nga Këshilli Shkencor i ISHA-së, sipas propozimit të Këshillit të etikës, ndaj personelit brenda ISHA-së, që kryejnë shkelje të integritetit në kërkimin shkencor dhe veprimtari artistike.
 11. **“Shkelje ose shkelje të rënda të integritetit në kërkimin shkencor dhe veprimtari artistike”** janë veprime që kryhen në bazë të përcaktimeve të këtij kodi.

PARIMET E VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ARTISTIKE

Neni 5

Liria e kërkimit shkencor dhe veprimtarive artistike

1. Kërkimet shkencore dhe veprimtaria artistike në ISHA garantohen nëpërmjet së drejtës për t'i përcaktuar çështjet e kërkimit apo veprimtarisë artistike, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme hulumtuese.

2. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike zhvillohen në mënyrë të pavarur, të pandikuara nga ndikimet ideologjike, politike, ekonomike, teknologjike, ose nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit.

Neni 6

Përgjegjësia e personelit të ISHA-së

1. Personeli i ISHA-së dhe personeli tjetër akademik – hulumtues, i përfshirë në projektet kërkimore-shkencore dhe artistike të ISHA-së, ka përgjegjësinë t'i zhvillojë dhe t'i zbatojë parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikës në kërkime shkencore në institucionet dhe disiplinat shkencore/artistike përkatëse, si dhe t'u përgjigjet në mënyrën e duhur rreziqeve ose shkeljeve të integritetit profesional.

Neni 7

Konflikti i interesit

1. ISHA-ja dhe kërkuesit duhet të identifikojnë dhe deklarojnë me kohë çdo konflikt interesi, qoftë të natyrës ligjore, etike, morale, financiare, personale ose të natyrave të tjera.

2. ISHA -ja dhe kërkuesit / hulumtuesit duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të pranojnë se konflikti i interesit (p.sh., konsiderata personale ose institucionale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në çështjet financiare dhe marrëdhëniet personale) mund të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në kërkimin shkencor dhe se identifikimi, deklarimi dhe adresimi i konfliktit të interesit është i nevojshëm për shmangien e praktikave të dobëta në kërkime ose sjellje jo etike në kërkime.

3. "Konflikti i interesit" është ri përfshirja e personave në çdo fazë të shqyrtimit apo vlerësimit të një hulumtimi ose kërkimi shkencor, objekt ankimimi, në të cilin kanë qenë pjesëtar, ose kanë pasur lidhje të mëparshme me të ose me autorin/autorët e tjerë.

4. Person i afërm – lidhje familjare nënkupton: bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jo pasuror me personelin e ISHA-së.

5. Konflikti profesional i interesit, do të përkufizohet si hulumtim që ka një interes në rezultatin e hulumtimit që nuk është në mënyrë eksplicite shkencore; duke përfshirë partnerë jo të bazuar në merita në projektin hulumtues; ose duke pasur një marrëdhënie paraprake financiare, politike ose sociale me ndonjë partner në projektin hulumtues që nuk është deklaruar në mënyrë eksplicite dhe me prioritet.

6. Nëse një konflikt interesi është i padeklaruar, por shfaqet gjatë pas periudhës së hulumtimit ose pas tij, personeli i ISHA-së ose personeli tjetër i angazhuar duhet ta deklarojë konfliktin e interesit.

7. Hulumtuesit që janë në konflikt interesi, sipas përcaktimeve të këtij kodi dhe Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, tërhiqen nga përfshirja në vendimet mbi financimin, emërimin, botimin, promovimin apo shpërblimin e autorëve të kërkimeve ose të botimeve shkencore.

8. Nëse personeli i përfshirë në projektin konkret hulumtues e ka ditur apo është dashur të dijë se gjendet në konflikt interesi dhe nuk e ka deklaruar, atëherë ndaj tij/saj duhet të ndërmerren masa sipas këtij kodi.

Neni 8

Parimet e kërkimit shkencor

1. Parimet themelore të integritetit në kërkime shkencore e orientojnë personelin e ISHA-së që në punën dhe angazhimin e tij të mbrohet ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që i shoqërojnë kërkimet shkencore, ose burojnë prej tyre. Këto parime janë:

- a. garancia për cilësinë e kërkimit;
- b. ndershmëria në zhvillimin e rezultateve dhe komunikimin transparent të tyre, në mënyrë të drejtë dhe me paanshmëri;
- c. respekti për kolegët;
- d. kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
- e. përgjegjësia sociale për kërkimin.

Neni 9

Praktikat e mira në kërkimin shkencor dhe veprimtaritë artistike

1. Kërkimi shkencor dhe veprimtaria artistike në ISHA udhëhiqet nga modeli i praktikave më të mira, të cilat përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- a. Mjedisin e kërkimit dhe veprimtarisë artistike;
- b. Trajnimin për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike;
- c. Udhëheqjen e kërkimit dhe të studimit;
- d. Procedurat e kërkimeve shkencore;
- e. Mbrojtjen e kërkimeve;
- f. Punën në grup dhe bashkëpunim;
- g. Botimin e rezultateve të kërkimit;
- h. Vlerësimin e kërkimit.

Neni 10

Mjedisi i kërkimit

1. ISHA udhëheq politika dhe zbaton procedura të mbështetura në praktikat më të mira të kërkimit shkencor dhe veprimtari artistike..

2. ISHA mbështet me infrastrukturë të nevojshme përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit në të gjitha format, të lidhura me riprodhimin, vazhdimësinë e kërkimit dhe përgjegjësinë sociale të rezultateve të kërkimit: statistikën, informacionet, procesin, dokumentet, etj.
3. ISHA inkurajon promovimin profesional dhe institucional të kërkuesve, nëpërmjet shpërblimit, meritokracisë dhe transparencës.

Neni 11

Trajnimi, mbikëqyrja dhe udhëheqja e kërkimit shkencor dhe veprimtarisë artistike

1. ISHA krijon kushte dhe ofron garanci për përditësimin teorik dhe trajnimin metodologjik të kërkuesve.
2. ISHA mbështet trajnimin e kërkuesve për zbatimin e normave të etikës dhe standardeve të integritetit, të pasqyruara në rregulloret përkatëse për kërkim shkencor dhe veprimtarinë artistike.
3. Kërkuesit me më shumë përvojë në fushën e kërkimeve mbështesin dhe nxisin zhvillimin e aftësive profesionale të kërkuesve më të rinj.

Neni 12

Përgjegjësia e përbashkët

1. Bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta marrin përgjegjësi për të garantuar integritet gjatë gjithë fazave të procesit kërkimor/hulumtues.
2. Bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta pajtohen në fillim të kërkimit/hulumtimit mbi qëllimet e punës kërkimore/hulumtuese/veprimtarisë artistike dhe komunikimin transparent mbi procesin dhe rezultatet e kërkimit.
3. Bashkëpunëtorët në kërkimet e përbashkëta pajtohen në fillim të kërkimit mbi standardet për integritetin e procesit kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët, si dhe mbi procedurat e trajtimit të mosmarrëveshjeve në rastet e shkeljeve të dispozitave të këtij kodi.
4. Bashkëpunëtorët pajtohen qysh në fillim mbi dërgimin ose jo për botim të rezultateve të kërkimit/hulumtimit shkencor.

Neni 13

Bashkautorësia në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike

1. Bashkëpunëtorët në kërkime/hulumtime shkencore dhe veprimtari artistike ia njohin kontributin njëri-tjetrit si bashkautorë në të gjitha fazat e kërkimit: konceptimit, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe interpretimit të rezultateve.
2. Bashkautorët sigurojnë që, në procesin e kërkimit, puna e secilit të jetë e qasshme për kolegët, në mënyrë të hapur, transparente, të saktë dhe në kohën e duhur.

3. Bashkautorët bëjnë të njohur çdo konflikt interesi, mbështetje financiare ose mbështetje të ndonjë lloji tjetër për kërkimin dhe/ose për botimin e rezultateve.
4. Kontributet e bashkëpunëtorëve të tjerë në kërkim, të cilët e ndihmojnë kërkimin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi duhet të njihen. Mosnjohja e kontributeve të të tjerëve konsiderohet si sjellje joprofesionale.
5. Bashkëpunëtorët pajtohen qysh në fillim mbi dërgimin ose jo për botim të rezultateve të kërkimit shkencor apo veprimtarisë artistike.

Neni 14

Botimi i rezultateve të kërkimit shkencor dhe veprimtarive artistike

1. ISHA-ja do t'i inkurajojë dhe mbështesë kërkuesit shkencorë / hulumtuesit që t'i publikojnë gjetjet e tyre;
2. Forma e botimit, mënyra, procedurat e botimit dhe koha e paraparë, përkatësisht formate përkrahjes për botim, rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 15

Kriteret e përfshirjes në kërkim shkencor dhe veprimtari artistike

Në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike përfshihen hulumtues shkencorë të cilët zotërojnë njohuri, metodologji dhe praktika etike të lidhura me fushën e tyre të kërkimit. Shmangia nga kjo përgjegjësi dëmton procesin e kërkimit dhe marrëdhëniet midis hulumtuesve, minon besueshmërinë e kërkimit shkencor dhe veprimtarisë artistike dhe shkakton shpenzime të pajustificuara të burimeve. Kjo përbën shkelje të integritetit në kërkimet shkencore dhe veprimtarinë artistike, e që dënohet me masat e parashikuara në këtë kod.

SHKELJET E INTEGRITETIT NË KËRKIMIN SHKENCOR, VERIFIKIMI, SHQYRTIMI DHE SANKSIONET

Neni 16

Komisioni i Etikës së ISHA-së

1. Shkeljet e integritetit në kërkimet shkencore dhe veprimtarinë artistike në ISHA, të parashikuara nga ky kod, verifikohen nga Komisioni i Etikës të ISHA-së.
2. Komisioni i Etikës i përcakton procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike në ISHA dhe i propozon Këshillit Shkencor për masat që duhen të shqiptohen ndaj personelit të ISHA-së duke u bazuar në këtë kod.

Neni 17

Emërimi i Komisionit të Etikës të ISHA-së

1. Komisioni i Etikës është organ i zgjedhur nga Komisioni Drejtues i ISHA-së. Drejtori i ISHA-së i propozon Këshillit Drejtues të ISH-së emrin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Etikës.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, nga një anëtar nga secila njësi akademike.
3. Mandati i komisionit zgjat 4 (katër) vjet.
4. Mandati i komisionit mund të pushojë para kohe:
 - a. Me vdekje të ndonjërit nga anëtarët e komisionit;
 - b. Me sëmundje të rëndë të ndonjërit nga anëtarët e komisionit, që ia pamundëson ushtrimin e funksioneve për më shumë se 6 (gjashtë) muaj;
 - c. me dorëheqje;
 - d. Shkeljes së këtij kodi etik.

Neni 18

Mënyra e punës së Komisionit të Etikës

1. Mënyra e punës së Komisionit të Etikës rregullohet me rregullore të veçantë, të cilën e miraton Komisioni Drejtues.

Neni 19

Detyrat e Këshillit Shkencor të ISHA-së mbi integritetin kërkimor-shkencor dhe veprimtari artistike

1. Detyrat e Këshillit Shkencor të ISHA-së në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike janë:
 - 1.1. T'i formulojë dhe t'i përcaktojë politikat, procedurat dhe dokumentet e praktikave më të mira në lidhje me kryerjen dhe publikimin e kërkimeve shkencore dhe artistike, të sigurojë që këto politika të zbatohen brenda fushave të përgjegjësisë;
 - 1.2. Të promovojë politika për integritet në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike bazuar në parimet etike që rregullojnë praktikën kërkimore;
 - 1.3. Të nxisë një mjedis që inkurajon qasje etike në fushat e kërkimeve dhe praktikave të kërkimit dhe botimin e tyre;
 - 1.4. T'i rishikojë praktikatat më të mira në kërkimet shkencore dhe veprimtari artistike, për të marrë parasysh zhvillimin e politikave etike dhe për të promovuar kërkimet brenda ISHA-së në çështjet e etikës dhe integritetit të kërkimit;
 - 1.5. Të shqyrtojë parimet etike të propozimeve për projekte kërkimore dhe të raportojë për to, duke siguruar që praktikatat e kërkimeve t'i përmbushin standardet e përgjithshme etike të vendosura brenda ISHA-së;

Neni 20

Shkeljet e rënda të integritetit në kërkime shkencore dhe veprimtari artistike

1. Shkelje të rëndë të integritetit në kërkimin shkencor dhe veprimtari artistike përbëjnë:

- a. Fabrikimi (Ofrimi i të dhënave të rreme);
- b. Falsifikimi (Shtrembërimi i të dhënave ose i gjetjeve);
- c. Plagjiatura (Vjedhja dhe përdorimi i të dhënave të autorëve të tjerë, pa autorizim paraprak).

Neni 21

Shkelje të tjera të integritetit në kërkime shkencore

Shkelje të integritetit në kërkimin shkencor dhe veprimtari artistike përbëjnë:

- a) manipulimi i autorësisë ose denigrimi i rolit të hulumtuesve të tjerë në kërkime;
- b) ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të mëhershme autoriale si gjetje të reja (autoplajjiatura);
- a) citimi përzgjedhës, me qëllim për t'i zmadhuar gjetjet e veta ose të redaktorëve, drejtuesve ose kolegëve;
- b) fshehja e pjesëve të rezultateve të kërkimit;
- c) lejimi i financuesve/sponsoruesve që ta rrezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve, me qëllim të krijimit të kuptimeve të njëanshme ose të paplota;
- d) zgjerimi në mënyrë të panevojshme të bibliografisë së kërkimit;
- e) akuzimi me keqdashje të hulumtuesve të tjerë për sjellje të papranueshme ose shkelje të tjera;
- f) zmadhimi i pajustificuar të rëndësisë dhe të zbatueshmërisë praktike të gjetjeve të kërkimit;
- g) vonimi ose pengimi i punës së hulumtuesve të tjerë;
- h) keqpërdorimi i pozitës më të lartë për të inkurajuar shkelje të integritetit kërkimor;
- i) fshehja e shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor të kryera nga persona të tjerë ose qëndrimet e papërshtatshme ndaj sjelljeve që shkelin Kodin e Sjelljes.
- j) themelimi ose mbështetja e revistave dhe botimeve të tjera grabitqare që minojnë kontrollin e cilësisë së kërkimit;
- k) fshehja e konfliktit të interesit;
- l) si dhe shkelje të tjera etike të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 22

Masat ndëshkuese

1. Masat ndëshkuese për personelin e ISHA-së, që bie ndesh me këtë kod janë:

1.1 Masat ndëshkuese të rënda për shkeljet e parapara në nenin 21:

- ✓ Pamundësim të pjesëmarrjes në projekte kërkimore-hulumtues në ISHA për periudhë 3-vjeçare;
- ✓ Degradim në thirrje akademike;
- ✓ Marrje e titullit akademik dhe largim nga puna.

1.2 Masat ndëshkuese të tjera për shkeljet e parapara në nenin 22:

- ✓ Vërejtje me shkrim, e cila mbet në dosje për 2 vjet;
- ✓ Mos financim të kërkimeve dhe projekteve për periudhë 2-vjeçare;
- ✓ 30% e pagës për tre muaj me radhë;
- ✓ Mospjesëmarrje në projektet ndërkombëtare për periudhë 2-vjeçare.

2. Vetëm një masë mund të merret për një çështje.

3. Nëse brenda 3 vjetësh personit i shqiptohen dy masa nga pika 1.2 e këtij neni, Komisioni i Etikës si masë të dytë e shqipton njëën nga masat e parapara në listën në pikën 1.1.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky kod hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i ISHA-së.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të ISHA-së

Prof. Dr. Armand Krasniqi

